



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 145, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE SHITESË TË ALOKUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.17, DATË 01.12.2022 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit shtesë prej 47’189’000 (dyzeteshtatë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të alokuar në zbatim të Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, si më poshtë:

Programi buxhetor	Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në mijë lekë
04960	Shlyerje e detyrimeve të prapambetura	602	47189
	TOTALI		47189

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





U shpall sot me datë 15.12.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 933 /
2 prot.

Durrës, më 20.12.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.145 datë 14.12.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondeve shtesë të alokuara në zbatim të Aktit Normativ Nr.17 dt 01.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 115/82021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

